



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **07/2025**

Data: **21 janar, 2025. Ora: 15:00**

Vendi: **Votim në procedurë qarkulluese (online)**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi.

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 04, 05 dhe 06/2025

2. Aktivitetet e Zyrës

- **Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve politike të certifikuara**

3. Këshillat e KQZ

3.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

- 3.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për pranimin dhe vlerësimin e dërgesave postare (zarfeve me fletëvotime) në hapësirat e Institucionit të Avokatit të Popullit;
- 3.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekzemplarëve (pre print) të fletëvotim dhe broshurës

3.2. Këshilli për Buxhet dhe Financa

- 3.2.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Prokurimit 2025;
- 3.2.2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për lejimin e pagesës të obligimeve të bartura nga viti 2024, për materialet zgjedhore;
- 3.2.3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për lejimin e pagesës - Furnizim me klima për KQZ, obligim i bartur nga viti 2024;
- 3.2.4. Shqyrtimi dhe miratimi i pagesë e anëtarësimit në RECEF.

3.3. Këshilli për Çështje Ligjore

- 3.3.1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Skenderaj.

4. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Në mbledhjen e 7-të, kryetari Radoniqi paraqiti agjendën si zakonisht dhe, tha se ka ndryshime në pikat e KOZ-it. **Arianit Elshani**, kryesues i këtij këshilli, i njoftoi të pranishmit në takim se janë disa pika të reja që duhet të përfshihen në mbledhje: zëvendësimi i anëtarit të KKZ-së në komunën e Deqanit, ndryshimi lokacionit të QKN-së në komunën e Gjilanit dhe Skenderajt, shqyrtimi dhe miratimi i procedurave të VPNV, shqyrtimi i procedurave të dorëzimit – pranimi të materialit zgjedhor në QKN, shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së KVV-e në përfaqësitë diplomatike, shqyrtimi dhe miratimi i

transportit të materialeve zgjedhor nga QKN në KVV, dhe shqyrtimi dhe rekomandimi për angazhimin e punëtorëve teknik në QNR dhe në QKN.

Alban Krasniqi, gjithashtu propozoi dy pika: miratimi i shtypjes së fletëvotimit me masat e sigurisë dhe miratimi formal i broshurës para se të shtypet, dhe autorizimi për drejtorin e sekretariatit për të bërë transportimin e dërgesave postare.

Me 9 vota për, u miratua rendi i ditës. Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së, miratuan edhe procesverbalet e mbledhjeve nr. 04, 05 dhe 06/2025.

Aktivitetet e Zyrës

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve politike të certifikuara:

Besnik Buzhala, drejtor i Sekretariatit dhe i Zyrës tha se janë përgatitur akreditimet e vëzhguesve për 21 subjekte politike. (Grupi i dytë) Afati ka filluar më 30 dhjetorë dhe ka përfunduar më 20 janar. Si më poshtë, z. Buzhala, pasqyroi para anëtarëve këtë listë të vëzhguesve Anëtarët e KQZ-së, me propozimin e z. Alban Krasniqi, i miratuan vëzhguesit e subjekteve në grup.

Nr.	Emri i Organizatës së Vëzhguesve	Akronimi	Lloji i Organizatës së Vëzhguesve	Grupi i dytë
1	Lëvizja VETËVENDOSJE!		Parti Politike	4356
2	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	PDK	Parti Politike	3939
3	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	LDK	Parti Politike	1968
4	KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTISI	KDTP	Parti Politike	257
5	SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA	SDU	Parti Politike	102
6	INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	IRDK	Parti Politike	158
7	SRPSKA LISTA		Parti Politike	290
8	AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS NISMA - Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët		Koalicion	3571
9	Opre Roma Kosova	ORK	Parti Politike	21
10	Koalicija Vakut		Koalicion	466
11	SRPSKI NARODNI POKRET	SNP	Parti Politike	88
12	Za Slobodu Pravdu i Opstanak	SPO	Parti Politike	96
13	Yenilikçi Türk Hareket Partisi	YTHP	Parti Politike	51
14	Koalicioni për familje	KPF	Koalicion	253
15	GRADJANSKA INICIJATIVA NARODNA PRAVDA	GI NP	Iniciativë Qytetare	26
16	PDAK-LPB		Koalicion	74
17	Naša Bošnjačka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka)	NBK	Koalicion	28
18	PARTIJA KOSOVSkih SRBA	PKS	Parti Politike	11
19	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	NDS	Parti Politike	40
20	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE- PLE	PLE	Parti Politike	36
21	Jedinstvena Goranska Partija	JGP	Parti Politike	58
				Totali: 15889

Numri i vëzhguesve të miratuar të grupit të dytë, me 9 vota për të anëtarëve të KQZ-së, është: **15, 889** vëzhgues. Nga 28 subjekte të certifikuara për të marrë pjesë në zgjedhje, në total, numri i vëzhguesve të 21 subjekteve politike që kanë aplikuar për vëzhgues për të dy grupet, është: **18, 163** vëzhgues.

3. Këshillat e KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për pranimin dhe vlerësimin e dërgesave postare (zarfeve me fletëvotime) në hapësirat e Institucionit të Avokatit të Popullit:

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar rekomandimin e Sekretariatit për shfrytëzimin e hapësirave të Avokatit të Popullit lidhur me pranimin dhe vlerësimin e dërgesave postare, të zarfeve me fletëvotime. Ky proces, do të filloj dhe të pranohen në hapësirat më lartë. Do ta kemi një marrëveshje, por edhe masat e sigurisë për mbarëvajtjen e punës. Ne, rekomandojmë të miratohet...

Gordan Llaban: A do të ketë kamera ?

Arianit Elshani: Po, përfshirë edhe sigurinë e policisë. Njëherit, edhe ne i kemi afër zyrat dhe, kjo është e rëndësishme.

Me 9 vota për, miratohet ky rekomandim.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i ekzemplarëve (pre print) të fletëvotim dhe broshurës:

Alban Krasniqi: Sipas rregullores, është e paraparë që fletëvotimet “pre – print” para se të fillohet me printimin e tyre, të miratohet nga KQZ. Bazuar edhe në rekomandim, jemi në fazën finale: shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave. Miratojmë për rekomandim.

Me 9 vota për, miratohet ky rekomandim.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i autorizimit të Sekretariatit për marrjen e dërgesave postare në Republikën e Malit të Zi:

Alban Krasniqi: Po, na duhet që Sekretariati të autorizohet për marrjen dhe sjelljen e dërgesave postare nga Republikën e Malit të Zi, dhe sjelljen e tyre në ambientet që sapo i miratuam. Ky autorizim të vlejë edhe për të gjitha rastet tjera deri sa të arrihet kontrata, por që paraprakisht të njoftohet KQZ për të gjitha rastet.

Me 9 vota për, miratohet ky rekomandim për autorizimin e drejtorit...

4. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të KKZ-së në komunën e Deçanit:

Arianit Elshani: Këshilli ka shqyrtuar një zëvendësim të anëtarit të KKZ-së në komunën e Deçanit nga subjekti PDK që ka dhënë dorëheqje. Prandaj, Isuf Mehmetaj rekomandojmë që të zëvendësohet me Lirie Turkajn – Buaj.

Me 9 vota për, miratohet ky zëvendësim.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit të lokacionit të QKN-së në komunën e Gjilanit dhe të Skenderajt:

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar në këshillë ndryshimin e lokacionit të QKN-së në komunën e Gjilanit dhe të Skenderajt. Në Gjilan, lokacioni i paraparë i qendrës komunale të numërimit ishte shkolla “Thimi Mitko”, mirëpo për shkak se është konsideruar si hapësirë e vogël, është rekomanduar që të jetë palestra sportive “Bashkim Selishta” e cila, ka një sipërfaqe prej rreth 1500 metra katror.

Rekomandimi për komunën e Skenderajt është që QKN e cila ishte paraparë të jetë palestra sportive e qytetit por që për shkak të pasigurisë nga reshjet e eventuale të shiut, ose edhe për shkak të mungesës së gjeneratorëve për ngrohje, është ndryshuar dhe tani rekomandohet që QKN e kësaj komune, të kalohet në sallën e edukatës fizike në shkollën “Anton Çeta”

Me 9 vota për, miratohet ky zëvendësim

5. Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave për votimin e personave me nevojave të veçanta:

Arianit Elshani: Këshilli ka shqyrtuar procedurën e votimit të të gjithë personave, kategorive, me nevoja të veçanta. Kjo është tashmë një praktikë e organizimit. Procedurat janë në përputhje me rregulloret, dhe me ligjin në fuqi. Këshilli, ka kërkuar formimin e ekipeve mobile që askush të mos mbetet pa votuar.

Prandaj, rekomandojmë për miratimin e këtij udhëzuesi për procedurat e votimit të personave me nevojat të veçanta....

Me 9 vota për, miratohen i procedurave për votimin e personave me nevojave të veçanta.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave të dorëzimit – pranimit të materialit zgjedhor në QKN:

Arianit Elshani: Këshilli ka shqyrtuar edhe procedurat e pranimit – dorëzimit të procedurave të materialit zgjedhor në qendrat komunale të numërimit. Bëhet fjalë për gjithë materialin e marra nga QKN-të dhe dërgimi i tyre në Vendvotime, dhe pastaj sjellja e tyre në QKN-të komunale. Këtu, parashihet edhe platforma e digjitalizimit e ndihmuar nga OSBE. Por, në rast problemi, kemi lënë edhe mundësinë e dorëzimit fizik të materialeve zgjedhore. Rekomandojmë për miratim.

Me 9 vota për, u miratua udhëzuesi i procedurave të dorëzimit – pranimit të materialit zgjedhor në QKN.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së KVV-e në përfaqësitë diplomatike:

Arianit Elshani: Kemi shqyrtuar edhe përbërjet e KVV-e në përfaqësitë diplomatike. Në fakt, jemi pak vonë. Por, disa parti kanë bërë nominimet. Numri maksimal i personave do të jetë 5: katër nga subjektet politike që janë pjesë parlamentare, dhe një zyrtar nga përfaqësitë diplomatike. Kryesuesit, janë të bartur nga një subjekt në tjetrin, varësisht nga renditja e tyre në tabelë. Është paraparë që në secilin ekip, të jetë një person rezervë sepse, duhet ti kemi parasysh vështirësitë eventuale. Prandaj, rekomandojmë miratimin.

Me 9 vota për, u miratua përbërja e KVV-e në përfaqësitë diplomatike.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i transportit të materialeve zgjedhor nga QKN në KVV

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar një çështje që është ngritur nga kryesuesit e komisioneve komunale të zgjedhjeve që ka të bëjë me transportimin e materialit zgjedhor. Ne, në rregullore kemi paraparë që, transportimi i kutive të bëhet nga kryesuesit bashkë me policinë me automjeteve të tyre private. Mirëpo, kjo ka shkaktuar vështirësi, dhe ne duhet ti kthehemi praktikës së mëhershme. Prandaj, duhet të kontraktojmë automjete të caktuara për bartjen e materialit.

Me 9 vota për, miratohet procedura e transportit të materialeve zgjedhor nga QKN në KVV.

9. Shqyrtimi dhe rekomandimi për angazhimin e punëtorëve teknik në QNR dhe në QKN:

Arianit Elshani: Këshilli, e ka shqyrtuar edhe këtë kërkesë për angazhimin e punëtorëve teknik në QNR dhe në QKN. Shumë qendra, janë shkolla fillore dhe ato kanë një drejtor, por drejtori nuk mund të angazhohet gjatë ditës së zgjedhjeve ta zëmë, edhe për mirëmbajtje të objektit. Është rekomanduar të angazhohen punëtorët teknik për mirëmbajtjen e objektit të QKN gjatë ditës së zgjedhjeve.

Alban Krasniqi, tha se lista e punëtorëve të angazhuar do të dërgohet nga komuna te KKZ, e KKZ te ne. Përbërja e tyre, do të jetë nga punëtorët dhe që tashmë punojnë në komuna.

Me 9 vota për, miratohet angazhimi i punëtorëve teknik në QNR dhe në QKN.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së menaxherëve të qendrave të votimit në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit:

Alban Krasniqi, tha se duhet ti autorizojmë – miratojmë menaxherët e zyrave, përfaqësive por edhe listën e stafit që do të punojnë, do të angazhohet në ditën e zgjedhjeve. Prandaj, rekomandojmë miratimin e listës, dhe të menaxherëve të përfaqësive diplomatike. (...nuk dëgjohet mirë incizimi i mëtejme i zhvillimit të mbledhjes...)

Në këtë pikë, kanë diskutuar: Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti dhe Alban Krasniqi por që diskutimet e tyre janë të pa zbardhshme nga stenogrami...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 7 vota për dhe 2 abstenime, u miratua listës së menaxherëve të qendrave të votimit në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit.

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Prokurimit 2025:

Gordana Llaban, kryesuese e këshillit për buxhet, tha se kemi mbajtur mbledhjen e parë për këtë vit. Kemi shqyrtuar dy pika: 1. Miratimin e planit e prokurimit 2025. 2. Kërkesën për lejimin e pagesës - Furnizim me klima për KQZ, obligim i bartur nga viti 2024. Në kuadër të pikës së parë, kemi shqyrtuar marrëveshjet e furnizimit në vlerë prej: 2, 329, 510 euro, dhe marrëveshjet për shërbime prej 631, 948 euro dhe marrëveshjet për punë: 95, 000 euro. Në total: 3, 560, 459 euro.

Kemi shqyrtuar një për një pikat, dhe ne rekomandojmë për votim.

Në këtë pikë, diskutuan: Alban Krasniqi... (nuk ka incizim)

Shqyrtimi dhe miratimi i pagesës së anëtarësimit në RECEF

Miratohet pagesa...

4.Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Skenderaj:

Sami Hamiti tha se, me kërkesën e kryesuesit të komunës së Skenderajt, kemi shqyrtuar një kërkesë për zëvendësim. Kështu që, janë plotësuar kushtet, edhe në pikëpamje ligjore sepse dokumentacioni është shqyrtuar nga këshilli, dhe ne rekomandojmë këtë zëvendësim.

Kreshnik Radoniqi: Azem Gashi, emërohet anëtarë i asamblesë komunale nga lista e pavarur “Bekim Jashari”, duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal z. Osman Smajli.

5. Të ndryshme